

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010) si dhe nenit 20, paragrafi 20.1, nënparagrafi d, dhe nenit 12, paragrafi 12.7, të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2022, miratoi këtë:

## RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PËRFITUESVE TË PENSIONEVE

### Neni 1

#### Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kritereve dhe kushteve për përcaktimin dhe anulimin e përfituesit të pensioneve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.
2. Kjo Rregullore zbatohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), për zbatimin e kritereve dhe kushteve për përcaktimin dhe anulimin e përfituesve të pensioneve.

### Neni 2

#### Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përcaktuar në nenin 1 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
  - 1.1. **Përfitues** – nënkupton një person fizik të cilin e ka caktuar pjesëmarrësi ose kur pjesëmarrësi nuk ka caktuar askënd apo nëse përfituesi i caktuar vdes para pjesëmarrësit, atëherë pjesëmarrësi e trashëgon atë i cili ka fituar ose mund të fitojë të drejtën në mjetet pensionale në bazë të të drejtave të pjesëmarrësit;
  - 1.2. **Përcaktimi i përfituesit** – nënkupton dokumentin e nënshkruar nga pjesëmarrësi të arkivuar në FKPK, me të cilin emëron përfituesin;
  - 1.3. **Përfituesi primar** – nënkupton personin fizik të titulluar për të pranuar beneficionin e pensionit të pjesëmarrësit të vdekur duke përjashtuar të gjithë përfituesit e tjerë;
  - 1.4. **Përfituesi i mundshëm** – nënkupton personin fizik i cili do të marrë të drejtën e përfituesit në rast se nuk ka përfitues primar të titulluar, sipas legjislacionit në fuqi, për të pranuar beneficionin e pensionit të pjesëmarrësit të vdekur;
  - 1.5. **Bashkëshorti** – nënkupton personin me të cilin pjesëmarrësi është i martuar me ligj ose personin me të cilin bashkëjeton pjesëmarrësi dhe i cili është i njohur si bashkëshort sipas certifikatës së bashkëjetesës, e vlefshme sipas ligjeve të Kosovës;

- 1.6. **Anulimi i përfituesit** – nënkupton dokumentin e arkivuar në FKPK nga pjesëmarrësi që anulon, ndryshon ose në ndonjë mënyrë tjetër e ndryshon përfituesin e emëruar;
- 1.7. **Person fizik** – nënkupton personat fizikë duke përfshirë personat fizikë të organizuar si shoqëri tregtare;
- 1.8. **FKPK** – nënkupton Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës;
- 1.9. **Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës** – nënkupton Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës si dhe ligjet pasuese për ndryshimin dhe/ose plotësimin e tij
- 1.10. **Pjesëmarrës** – nënkupton personin fizik në emër të të cilit punëdhënësi ose pjesëmarrësi i paguan kontributet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

### **Neni 3 Përcaktimi i Përfituesit**

1. Kushtet për përcaktimin e personit fizik si përfitues primar në FKPK janë si në vijim:
  - 1.1. Personi fizik i emëruar nga pjesëmarrësi duhet të parashtrijë kopjen e letërnjoftimit si dhe/apo certifikatën e gjendjes civile dhe/apo certifikatën e bashkëjetesës;
  - 1.2. Pjesëmarrësi i cili në kohën kur e përcakton përfituesin është i martuar, ai/ajo duhet të emërojë si përfitues primar bashkëshortin/bashkëshorten e tij/saj;
  - 1.3. Bashkëshorti/ja, me të cilin pjesëmarrësi ka qenë i martuar ose me të cilin ka bashkëjetuar për së paku një (1) vit para vdekjes së tij dhe që është përcaktuar nga pjesëmarrësi si përfitues i asaj apo atij ka përparësi ndaj të gjithë përfituesve të tjerë;
  - 1.4. Bashkëshorti/ja me të cilin pjesëmarrësi ka qenë i martuar ose me të cilin ka bashkëjetuar së paku një (1) vit para vdekjes së tij është përfituesi primar, pavarësisht se a e ka bërë pjesëmarrësi emërimin e tij/saj si përfitues të tillë dhe ka përparësi ndaj të gjithë përfituesve të tjerë të mundshëm;
  - 1.5. Bashkëshorti/ja, me të cilin pjesëmarrësi ka qenë i martuar ose me të cilin ka bashkëjetuar për së paku një (1) vit para vdekjes së pjesëmarrësit dhe nuk është përcaktuar nga pjesëmarrësi si përfituesi i asaj apo atij ndan të drejtën e barabartë me përfituesin(it) tjetër primar që paraprakisht kanë qenë të përcaktuar si përfitues nga pjesëmarrësi;
  - 1.6. Pjesëmarrësi i cili në kohën kur përcakton përfituesin është i pamartuar mirëpo ka një fëmijë ose më shumë fëmijë duhet të përcaktojë të gjithë fëmijët e saj apo tij si përfitues;
  - 1.7. Pjesëmarrësi i cili në kohën kur e përcakton përfituesin është i pamartuar dhe nuk ka fëmijë, mund të përcaktojë çdo person fizik si përfitues të atij apo asaj. Në rast se nuk ka përfitues primar në kohën e pagesave të beneficioneve të pensioneve, të gjithë personat e emëruar duhet të kenë hise të barabartë;
  - 1.8. Fëmija i pjesëmarrësit, pavarësisht se a është përcaktuar ose jo do të konsiderohet si përfitues(it) primar/ë, në rast se pjesëmarrësi nuk ka bashkëshort i cili mund të ushtrojë të drejtën e përfituesit primar në kohën e pagesës së beneficionit të pensionit;
  - 1.9. Ndarja e beneficioneve të pensioneve për të gjithë përfituesit primarë, nëse janë më shumë se një, duhet të bëhet në mënyrë të barabartë.
2. Personi fizik i përcaktuar si përfitues i mundshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- 2.1. Përfituesi(it) e mundshëm përcaktohen nga pjesëmarrësi dhe/apo sipas legjislacionit në fuqi;
  - 2.2. Ekzistenca e përfituesit(ve) primar(ë) përjashton të drejtat e përfituesit(ve) të mundshëm;
  - 2.3. Ndarja për përfituesit e mundshëm duhet të jetë e barabartë për të gjithë;
  - 2.4. Përfituesit e mundshëm kanë të drejtë të pranojnë beneficionet e pensionit të pjesëmarrësit të vdekur vetëm në mungesë të përfituesit primar ose kur nuk ka caktim efektiv të përfituesit primar.
3. Përfituesi(it) i/e pjesëmarrësit të vdekur i cili nuk ka bashkëshort/e dhe i cili nuk e ka përcaktuar përfituesin, përfitues janë të gjithë fëmijët e saj apo atij ose nëse ajo apo ai vdes pa pasur fëmijë, atëherë trashëgimtari i saj apo i tij më i afërt i cili mund të caktohet sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 4** **Anulimi i përfituesve**

1. Pjesëmarrësi ka të drejtë që të anulojë përcaktimin e përfituesit të saj apo tij, varësisht prej kufizimeve në vijim:
  - 1.1. Pjesëmarrësi mund të anulojë në çdo kohë emërimin e përfituesit por jo të bashkëshortit/ës me të cilin është i martuar;
  - 1.2. Pjesëmarrësi nuk mund të anulojë emërimin e bashkëshortit ose bashkëshortes me të cilin ajo apo ai është i martuar ligjërisht, si përfitues i beneficionit të pensionit të saj apo tij;
  - 1.3. Aktgjykimi i formës së prerë për shkurorëzim nuk mund të veprojë si anulim i emërimit të përfituesit;
  - 1.4. Pjesëmarrësi i cili është palë për shkurorëzim mund të anulojë emërimin e bashkëshortit/ës të saj apo tij (palë në shkurorëzim) pas vendimit të formës së prerë të gjykatës sipas procedurave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje;
  - 1.5. Nëse ky anulim nuk është bërë para vdekjes së pjesëmarrësit, bashkëshorti/ja i/e shkurorëzuar nuk mund të përjashtojë të drejtat e përfituesve të tjerë primarë si bashkëshorti/ja ligjore në momentin e vdekjes apo fëmijët.

#### **Neni 5** **Kërkesat për emërimin ose anulimin valid dhe efektiv të përfituesit**

1. Caktimi dhe anulimi i përfituesit, që të jetë valid dhe efektiv, duhet të jetë në pajtueshmëri me kërkesat në vijim:
  - 1.1. Duhet të jetë bërë nga pjesëmarrësi gjatë kohës kur ai/ajo është gjallë dhe para fillimit të përfitimit të beneficionit të pensionit;
  - 1.2. Nuk duhet të ndryshojë të drejtat e bashkëshortit/ës të pjesëmarrësit në kohën e emërimit;
  - 1.3. Duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga pjesëmarrësi dhe të jetë pranuar nga FKPK;

- 1.4. Duhet të jetë në përputhshmëri me kërkesat e aplikueshme të rregullave të emërimit të përfituesit të FKPK që janë në pajtim me këtë Rregullore, Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës dhe legjislacionin në fuqi.

## **Neni 6**

### **Përmbushja e obligimeve**

Pagesa ose pagesat e beneficionit të pensioneve të bëra nga FKPK-ja në pajtim me këtë Rregullore i përmbushin obligimet e kujdestarëve ndaj çdo personi, që bën kërkesë si përfitues i pjesëmarrësit të vdekur.

## **Neni 7**

### **Pagesa fazore**

1. Pagesat fazore mund të bëhen nëse vlera e llogarisë individuale e tejkalon vlerën e pragut apo kufirit të aprovuar nga BQK-ja.
2. Pagesat fazore për përfituesit nëse pagesa fazore e beneficioneve ka filluar të bëhet nëpërmes ndonjë institucioni tjetër dhe pjesëmarrësi vdes para pranimit të të gjitha pagesave, ai institucion duhet të zbatojë kërkesat për përcaktimin e përfituesit/ve, të përcaktuar me këtë Rregullore dhe të paguajë përfituesit/ve, pagesat që kanë mbetur. Institucioni duhet të mbajë shënime të caktimit të përfituesit dhe të ofrojë mundësi për anulimin e caktimit të përfituesit nëse kjo kërkohet.

## **Neni 8**

### **Zbatimi dhe masat përmirësuese**

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të përcaktuara me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës.

## **Neni 9**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregulla 25 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Përcaktimin e Përfituesve të Pensioneve të datës 17 prill 2003, e miratuar më datë 16 mars 2006.

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës